



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 4/2 Prot

Tiranë, më 05.01.2023

VENDIM  
Nr. 01, Datë 5.01.2023

“PËR

**MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE TË MENJËHERSHME TË  
PUNONJËSVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME DHE  
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PUBLIK PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT  
TË KRIZËS ”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015“Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika h; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;Ligjit nr.115 / 2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “ Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MAS dhe MFE “ Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; VKM-së Nr.898 datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëherëshme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithëshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”; pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Administratori i UT-së; Senati Akademik në mbledhjen e datës 05/01/2023

**Vendosi:**

1. Miratimin e fondit të mbështetje financiare të punonjësve të Universitetit të Tiranës sipas VKM-së nr 898 datë 29.12.2022. “Për mbështetje financiare të menjëherëshme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithëshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik për zbutjen e impaktit të krizës”
2. Burimi i financimit për këtë mbështetje financiare të jenë të ardhurat e Universitetit të Tiranës për vitin 2022. Pagesat të kryhen nga llogaria 606/6 (Transferime tek individët).
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim në përputhje me nenin 49, pika 1, gërma ç të ligjit nr. 80/2015.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**PROF. DR. ARTAN HOXHA**

